



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-PR-2020-09

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 1 maj 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik me shtojcë konfidenciale

**Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave
drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese**

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 19(5) dhe 32(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 7(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), i referon Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ndryshimet e miratuara të Rregullores.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 dhe 30 prill 2020, gjatë mbledhjes së tyre plenare, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës, miratuan ndryshime të 30 rregullave në pajtim me nenin 19(4) të Ligjit dhe rregullën 7(5) të Rregullores.¹

II. REFERIMI

2. Në nenin 19(5) të Ligjit dhe rregullën 7(6) të Rregullores përcaktohet se ndryshimet e miratuara të Rregullores i referohen Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për të garantuar përputhjen e tyre me Kapitullin II, ndër të tjera me nenin 55, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

3. Ndryshimet e miratuara sipas nenit 19(4) të Ligjit dhe rregullës 7(5) të Rregullores përfshihen në shtojcën konfidenciale të bashkëngjitur.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA I REFERON

Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ndryshimet e miratuara të Rregullores.

¹ Në përputhje me nenin 19(1) të Ligjit dhe rregullës 7(2) të Rregullores, gjykatësit e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese nuk morën pjesë në miratimin e ndryshimeve të Rregullores.

/nëshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 1 maj 2020
Në Hagë, Holandë.